

## KONFERENCA PËR BUJQËSI TË QËNDRUESHME DHE VENDIMMARRJEN E BAZUAR NË TË DHËNA

I/E Nderuar,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me PPSE, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest, ju ftojnë të merrni pjesë në Konferencën për Bujqësinë e Qëndrueshme dhe Vendimmarrjen e Bazuar në të Dhëna. Konferenca do të mbahet më **17 Tetor 2024**, në **Hotel Emerald, Prishtinë**, duke filluar nga ora 09:30.

Konferenca do të mbledhë së bashku aktorët kryesorë nga sektori publik dhe privat, shoqëria civile, komuniteti akademik, donatorët ndërkombëtarë, mediat dhe të gjithë të interesuarit për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme në Kosovë.

Në kuadër të konferencës do të prezantohet Platforma për Matjen e Ndikimit të Granteve për Masën 1 / Serra, dhe rezultatet e Raportit Gjithëpërfshirës Hulmues mbi Bujqësinë e Qëndrueshme në Kosovë, i komisionuar nga PPSE, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

### AGJENDA

#### BUJQËSIA E QËNDRUESHME DHE VENDIMMARRJA E BAZUAR NË TË DHËNA 17 Tetor 2024, 9:30 | Emerald Hotel, Salla Strauss 1, Prishtinë

Koha	Tema
9:00 - 9:30	<b>Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe kafe</b>
9:30 - 9:50	<b>Fjalët hyrëse</b> Z. Faton Peci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) Z. Jean-Christophe Favre, Swiss Cooperation Office – Ambasada e Zvicrës
9:50 - 10:00	<b>Prezantimi i Trendeve të Zhvillimit të Sektorit</b> Z. Avni Ramadani, PPSE - Swisscontact
10:00 - 10:50	<b>Mbështetja Institucionale për Sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b> Znj. Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në MBPZHR  <b>Përkrahja e Sektorit të Bujqësisë përmes Granteve dhe Vendimmarrja e Bazuar në të Dhëna.</b> Z. Lulzim Shamolli, UD i Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural
10:50 - 11:30	<b>Diskutim i hapur, pyetje &amp; përgjigje</b>
11:30 - 12:30	<b>Dreka</b>
12:30 - 12:50	<b>Prezantimi i Rezultateve të Studimit për Bujqësinë e Qëndrueshme</b> Z. Egzon Bajrami, Konsulent
12:50 - 13:30	<b>Njohuritë nga Terreni: Përvojat e Sektorit Privat me Praktikën e Bujqësisë së Qëndrueshme në Kosovë</b> Z. Skender Ramadani, Fidanishtja e Godancit Z. Karsten Klapp, Go Beyond Z. Driart Mehmetaj, Biosource shpk
13:30 - 14:15	<b>Panel diskutimi, moderuar nga Prof. Arben Mehmeti</b> E Ardhmja e Bujqësisë së Qëndrueshme dhe Politikave të Nxitjes Z. Imri Demelezi, zv. Ministër i MBPZHR Znj. Laura Courbois, Swisscontact Z. Naser Krasniqi, FAO Znj. Klodiana Balla, Bio Inspecta Z. Kastriot Këpuska, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
14:15 - 14:30	<b>Pyetje dhe Përgjigje</b>

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.